

Data 25.08.2023.

**PROCESVERBAL**  
**Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“KANCELARI DHE TONERA FOTOKOPJE DHE PRINTERASH”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Kodi CPV, 30125120-8;30192124-6;30197643-5.*

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1 333 333,33**(Njemilion e treqind e tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e tre) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Bulqize** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertës ekonomike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):  
Sipas kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.**Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimale deri në 3(tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të paktën 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-se, për të cilin duhet të paraqitet vertetim i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq Operatorët Ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

**2.2.2.** Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2021 -2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2022, (per NIPT-in kryesor), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**Argumentimi:**Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrjnë aktivitet.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Pervoja e ngjashme :**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontrata te meparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet te jete te minimalisht deri ne 20% e vlerës te kontrates qe po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese sidëshmipërpervojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një entepublik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.( Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Aftesite teknike dhe profesionale**

**2.3.2.** Deklarate nga OE që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi sipas kërkesave të Bashkisë Bulqize.

**2.3.3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë për cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallrat e ofruar si dhe nderrimin në rast se nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK. Për përmbushjen e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor se operatori merr përsipër zëvendësimin e mallrave dhe levrimin sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK. Gjithashtu operatori ekonomik të përshijë në deklaratë duke garantuar AK se ofron garanci për mallrat objekt prokurimi duke i'u referuar periudhës së kërkuar në specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike dhe aftesite profesionale në përmbushjen dhe realizimin e kontratës, si edhe shërbejnë për vlerësimin e ofertës teknike/ekonomike.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet transporti**, për transportin e materialeve të kërkuara në preventiv, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale), leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Njesia e Prokurimit